Celje e vitit 2025	**30,040,665**
Shtesa (K)	462,318,104
Pakësime (D)	460,660,467
Gjendja në 31.12.2025(K)	**31,698,302**

- **Llogaria 431, "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa"**, paraqitet në 2,209,577 lekë dhe përfaqëson vlerën për t'u paguar për taksa e tatime ndaj shtetit për muajin dhjetor.

Llog. 431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa"	
Celje e vitit 2025	**1946450**
Shtesa (K)	26,675,760
Pakësime (D)	26,412,633
Gjendja në 31.12.2025(K)	**2,209,577**

- **Llogaria 435, "Sigurime shoqërore" dhe llogaria 436 "Sigurime shëndetësore"** paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor që paguhen në muajin janar dhe janë perkatsisht në vlerat 9,524,292 lekë dhe 1,313,397 lekë.

Llog. 435 "Sigurime shoqërore"	
Celje e vitit 2025	**9,065,074**
Shtesa	114,512,335
Pakësime	114,053,117
Gjendja në 31.12.2025	**9,524,292**
Llog. 436 "Sigurime shëndetësore"	
Celje e vitit 2025	**1,250,217**
Shtesa	15,787,500
Pakësime	15,724,320
Gjendja në 31.12.2025	**1,313,397**

Llogaria 466 "Kreditore për mjete nën ruajtje", sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Maliq, në fund të vitit 2025 paraqitet në vlerën 42,196,944 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%, ose shumën 38,745,994 lekë , vlerën e pullave të gjendjes civile të muajit dhjetor në shumën 69,350 lekë dhe vlerën e sigurimit të kontratës të shoqërisë Rozafa në shumën 3,381,600 lekë. Vlera e mësipërme është e rakorduar me Degën e Thesarit Korçë, sipas aktrakordimit të konfirmuar me Shkresën nr. 1221 prot, datë 26.02.2025.

Llog. 466 "Kredirorë për mjete në ruajtje"	
Celje e vitit 2025	43,513,273
Shtesa	14,428,560
Pakësime	19,195,839
Gjendja në 31.12.2025	**38,745,994**

Llogaria 467 "Kreditorë të ndryshëm", paraqiten faturat e pa likuiduara për investime dhe shërbime të cilat për vitin 2025 paraqiten në shumën 857650 lekë. Lëvizja e kësaj llogarie gjatë vitit 2025 paraqitet si më poshtë:

Llog. 467 "Kredirorë të ndryshëm"	
Celje e vitit 2024	**1144318**
Shtesa	4053297
Pakësime	4339965
Gjendja në 31.12.2024	**857650**

Siç shihet edhe nga tabela llogaria 467 paraqitet në shumën 857650 lekë përfaqëson vlerën e pullave të paderdhura në shumën 296000 lekë , vlerën e blloqeve të transportit në shumën 85,500 lekë dhe vlerën e biletave të tregut në shumën 166650 lekë dhe bileta për pyllin e fazanëve në shumën 195000 lekë,Bileta sporti 114,500 lekë.

LLogaria 85 "Rezultati i ushtrimit", paraqitet me tepricë kreditore në vlerën 119032062 lekë dhe paraqet rezultatin nga funksionimi. Ajo është e barabartë me vlerën e të ardhurave që Bashkia Maliq trashëgon për t'u përdorur në vitin pasardhës sipas dispozitave ligjore në fuqi dhe në përputhje me akt-rakordimin e mbajtur me degën e thesarit mbi fondet që trashëgohen si më poshtë:

Llog. 85 "Rezultati i ushtrimit"	
Celje e vitit 2025	**97202603**
Shtesa(te ardhurat)	1360504564
Pakësime	1338675105
Gjendja në 31.12.2025	**119032062**

Rakordimi i Shpenzimeve

në 000/lekë

Emertimi	**Sipas Situacionit**	**Detyrimet e vitit 2024**	**Detyrime të vitit 2025**	**Sipas Pasyrës së Performancës**
600	462,007,312	36,202,011	38,336,500	464,141,801
601	76,986,044	6'128'295	6,438,608	77,296,357
602	162,608,248	7'033'584	14,670,476	170,245,140
604	24,153,211	0	0	24,153,211
606	441,892,580	0	0	441,892,580
63	-38,104,677		0	-38,104,677
Totali	**1,129,542,718**	**36,202,011**	**59,445,584**	**1,139,624,412**

Diferenca në shumën 10081694 lekë midis shpenzimeve të paraqitura në Pasqyrën e Performancës Financiare dhe sipas Situacionit përbëhet nga diferenca midis detyrimeve të muajit Dhjetor 2025 të paguara në Janar 2025 dhe detyrimeve të Dhjetorit 2025 të paguara në Janar 2026 në shumën 10081694 lekë, si dhe vlerës prej(-)38,104,677 lekë "Ndryshimi i gjendjes së inventarit".

Në fund të vitit ushtrimor të dy llogaritë e klasës 6 "shpenzimet" dhe klasës 7 "të ardhurat", janë mbyllur duke debituar dhe kredituar respektivisht llogarinë 85 "Rezultati i veprimtarisë ushtrimore", konkretisht:

Rakordimi të ardhura, shpenzime dhe rezultati

	Emërtimi Burimi	**Pasqyra**	**Situacioni**
I	**Totali të ardhura**	1,360,504,564	
II	Shpenzime	1,241,472,502	1,490,866,863
III	Rezultati i vitit ushtrimor	119,032,062	

Në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, llogaria 85 "Rezultati nga veprimtaria" paraqitet në shumën

119,032,062 lekë,

Raporti i veprimtarisë për zbatimin e Buxhetit për vitin 2025

Më poshtë po japim një përmbledhje të ecurisë së zbatimit të buxhetit të vitit 2025 për Bashkinë Maliq për periudhën: Janar – Dhjetor 2025.

Drejtoria e Financës e organizon punën e saj sipas ligjit nr. 139/2015, dt. 17.12.2015, " Për Vetëqeverisjen Vendore".dhe ne zbatimin me korrektësi të V.K.Bashkiak Maliq 130 dt 26.12.2024 të Këshillit Bashkiak "Për miratimin e buxhetit për vitin 2025", mbështetur në vendimin nr 4 dt 31.01.2025 të Këshillit Bashkiak "Për miratimin e buxhetit shtesë për vitin 2025

Pas miratimit në Këshillin Bashkiak, u detajua buxheti për vitin 2025 për Bashkinë . Gjatë periudhës janar – dhjetor 2025 ne si Drejtori kemi punuar per te realizuar te gjitha detyrat e ngarkuara.

Cdo muaj eshte bere perpilimi i raportit përfundimtar të shpenzimeve dhe të ardhurave mujore dhe progresive (situacioni i shpenzimeve buxhetore dhe te ardhurave), kalimi i veprimeve ne Thesar për likuidimet e detyrimeve aktuale paga,furnitore etj. Kontabilizimet në ditarët e bankës ,arkës dhe llogarisë materiale Hyrje Dalje dhe partitaret përkatës . Ndjekja dhe zbatimi i Regjistrit të Parashikimit te Prokurimeve Publike dhe planit të buxhetit të miratuar për vitin 2025, sipas limiteve mujore të përcaktuara.

Ndjekja dhe zbatimi i procedurave ligjore për prokurimin publik, për plotësimin e nevojave të institucionit të Bashkisë Maliq , për mallra/punëve dhe shërbime deri në kryerjen e likuidimit përfundimtar.

Njohja me problematikën dhe materialet e ardhura në adresë te Drejtorisë, konceptimi dhe kthimi i përgjigjeve sipas destinacionit.

TË ARDHURAT E BASHKISË per Vitin 2025

Raporti i të ardhurave sipas zërave

Tabela përmbledhëse e realizimit të të ardhurave sipas zërave për vitin 2025

Nr	Emërtimi	viti 2024			viti 2025		
		Plan vjetor	Fakt	%	Plan vjetor	Fakt	%
	Të ardhura tatimore						
1	Taksë Ndërtese	22 192	13 873	63%	22 624	13 450	59%
2	Taksë Trualli	2 719	3 230	119%	2 592	2 341	90 %
3	Taksë Toke	51 289	27 386	53%	51 111	23 313	46%
4	Taksë tabele	425	762	179%	2 548	1 260	49%
5	Taksë Tregu	600	338	56%	320	342	107%
6	Taksë Ndikimi në infrastrukturë dhe ndërtime të reja	15 000	9 011	60%	15 000	14 159	94%
7	Tatim i thjeshtuar	250	331	132%	350	166	47%
8	Taksa vjetore e mjeteve të përdorura.	15 500	18 448	119%	18 500	20 839	113%
9	Taksë mbi Rentën Minerare	500	307	61%	250	241	96%
10	Të ardhura nga ASHK	700	4	1%	10	1 050	10500%
11	Të Ardhura nga Qiraja	6 520	11 459	176%	8 211	12 845	156%
12	Tatim mbi TAP	13 000	18 499	142%	16 000	21 649	135%
13	Lejë për shitje me pakicë të karburanteve	5 400	3 600	67%	8 000	7 260	91%
	Shuma I	134 095	107248	80%	145 516	118 915	82%
	Të ardhura jo tatimore						
1	Tarifë Pastrimi	49 268	27 169	55%	58 186	28 415	49%
2	Tarifë Ndricimi	19 171	8 642	45%	21 950	8 397	38%
3	Tarifë Gjelberimi	3 734	2 307	62%	4 068	2 330	57%
4	Regjistrim Automjete në Bashki	279	373	134%	379	296	78%
5	Tarifë Parkimi	696	647	93%	713	630	88%
6	Tarifa të ndryshme në Bashki	2 500	1 009	40%	2 100	1 118	53%
7	Kullotat	200	206	103%	200	61	31%
8	Të ardhura nga drutë e Zjarrit.	60 000	3	0%	36 000	0	
9	Mjete Korrëse	150	130	87%	130	105	81%
10	Tarifë Uji për uitje	11 200	2 258	20%	11 310	870	8%
11	Tarifë per mirembajtje kanale kulluese	5 877	2288	39%	4 794	1 972	41%
12	Tarifë për MirëmbajtjeVarrezash	7341	3725	51%	9 676	3 297	34%
13	Bileta sporti, Kulture, udhëtimi	210	135	64%	210	115	55%
14	Tarifa Administrative	148	647	437%	151	380	252%
15	Kazan Rakije	60	10	17%	0	0	

16	Leja Non Stop	165	30	18%	0	0	
17	Gjoba të ndryshme	1200	744	62%	1 010	751	74%
18	Tarifë mjedisore	1910	1580	83%	1 511	1 686	112%
19	Tarifë për mbrojtje nga zjarri	70	91	130%	1 000	118	12%
20	Sponsorizime	0	9569		0	1 716	
21	Tarifë për linjat	2 150	800	37%	1 000	400	40%
22	Grande ngaQarku	0	473	0	0	14 585	
23	Shitje skrapi	0	264	0	0	0	
24	Tarifë për Zënie Hapësirë Publike	100	108	108%	146	74	51%
26	Dividend	0	485	0	0	0	
	Shuma II	166 429	63 693	38%	154 534	67 316	44%
	Shuma I+II	300 524	170 941	57%	300 050	186 231	62%
	TOTALI	300 524	170941	57%	300 050	186 231	62%

Të ardhurat për vitin 2025 u realizuan në shumën ***186 231 mijë*** **lekë** , ose 62 % të planit.

Të ardhurat tatimore për vitin 2025 u realizuan në shumën ***118 915 mijë lekë,*** ose 82% të planit të vitit 2025. Krahasuar me vitin 2024 të ardhurat kanë pësuar një rritje prej ***11 667 mijë*** lekë.

Në këtë grup të ardhurash, peshën kryesore e zë "*Taksa e Pasurisë sëPaluajtshme*" me një realizim të ardhurash prej 39 104 mijë lekë, ose 51% ndaj planit,"*Taksë ndikimi në infrastrukturë dhe ndërtime të reja*" me një realizim prej 94% ndaj planit ,"*Të ardhura nga qiraja*" me një realizim të ardhurash në masën 156% ndaj planit , zëri "*Tatim mbi të ardhurat personale*" i cili është realizuar në masën 135% si dhe zëri "*Taksa vjetore e mjeteve të përdorura*" që është realizuar në masën 113%.

Të ardhurat jotatimore për vitin 2025 u realizuan në shumën **67 316 mijë lekë**, ose 44 % të planit vjetor me një rritje prej 3 623 mijë lekë krahasuar vitin 2024.

Në këtë grup të ardhurash, peshën kryesore e zë "Tarifa e pastrimit" me një realizim prej 28 415 mijë lekë ose 49% të planit vjetor, "Tarifa e ndriçimit" që është realizuar në masën 8 397 mijë lekë ose 38% të planit vjetor, "Tarifa e gjelberimit" që është realizuar në masën 57%, "Tarifë mirëmbajtje kanalesh kulluese që është realizuar në masën 41% dhe tarifa për mirëmbajtje varrezash që është realizuar në masën 34%.

Nënvizojmë faktin se të ardhurat e vitit 2025 janë realizuar në masën 62 % ndaj planit me një rritje të ardhurash prej **15 290** mijë lekë krahasuar me vitin 2024.Të ardhurat në Bashkinë Maliq kanë ardhur duke u rritur nga viti në vit. Megjithatë duhet të theksojmë faktin se gjatë proçesit të mbledhjes të të ardhurave , problem kryesor që hasim, është ulja e numrit të familjeve rezidente si rezultat i largimit të familjeve(Brenda ose jashtë vendit) duke ndikuar në realizimin e të ardhurave për grupin familjar, duke rritur riskun për mbledhjen e detyrimeve të tyre.

SHPENZIMET E BASHKISE

-Realizimi i shpenzimeve për periudhën Janar -Dhjetor 2025:

Më poshtë jepet realizimi i shpenzimeve në periudhën janar-dhjetor 2025,krahasuar me planin 12 -mujor për Bashkinë Maliq .

000/ lekë

Llog	Plani	Fakti	Mbetja	Realizimi ne %
600	508,850	463,456	45,394	91.1
601	77,303	75,732	1,571	98.0
602	186,247	163,270	22,977	87.7
604	24,604	24,153	451	98.2
606	445,626	441,364	4,262	99.0
609	670		670	0.0
466		19,726	- 19,726	
230	7,030	4,712	2,318	67.0
231	313,815	298,453	15,362	95.1
Shuma	**1,564,145**	**1,490,866**	**73,279**	**95.3**

Tabela e mësipërme pasqyron faktin e shpenzimeve gjate 12 mujorit janar-dhjetor 2025 kundrejt planit vjetor,ku futen transfertat e pakushtëzuara dhe specifike,buxheti i pavarur i realizuar dhe transferta e kushtëzuar.

Nga tabela rezulton se në total fondet jane realizuar në fakt me shumën 1,490,866 mije lekë ,ndersa fondet e planit agregat 12 mujor jane ne shumen 1,564,145 mije lekë ,përdorimi I fondeve me efektivitet 95.3%.

Krahasimin e kemi bere me planin agregat vjetor te realizuar ne fakt.,kurse nqs e bejme krahasimin me planin buxhetor te miratuar, por te parealizuar ,realizimi del 87.3 % si plan vjetor eshte ne vleren 1,707,816 mije lekë kurse fakti 1,490,866 mije lekë..

Në nivel artikulli realizimi i fondeve ne total rezulton si më poshtë:

-Shpenzimet për paga janë realizuar në masën 91.1 % të planit 12-mujor , po kështu edhe **shpenzimet për sigurime shoqërore** rezultojnë me një realizim 98 % kundrejt planit 12 mujor

-Shpenzimet operative janë likujduar në masën 87.7% të planit të përgjithshëm 12 mujor

Projektet jane ne masen 67 % te planit 12 mujor .

Investimet janë likujduar në masën 95.1% të kontratave të çelura në sistemin e thesarit.

Shpenzimet e kryera për investime janë shpenzime për vitin 2024, për shkak te mungeses të fondeve,Për vitin 2025 janë realizuar procedurat e prokurimit për investimet e planifikuara ,janë lidhur kontratat por nuk eshte bërë likuidimi ,sepse objektet nuk kanë përfunduar, gjithashtu kontratat jane lidhur ne fund të vitit por dhe per mungesë fondesh.

-Shpenzimet e tjera janë realizuar në fakt 99 %. Në këtë zë përfshihen shpenzimet e kryera për pagesat e paaftesisë dhe ndihmes ekonomike

Gjithashtu theksojmë se,*gjate vitit 2025 kemi patur dhe mos realizime te shpenzimeve si ato operative dhe ato per investime* , s hkak për mos likujdimin e shpenzimeve operative dhe investimeve të kryera ka qënë pamjaftueshmëria e fondeve, e mosrealizimit të të ardhurave të planifikuara, të cilat nuk janë realizuar në nivele të kënaqshme,si 12 mujor për këtë arsye kemi fatura të palikuiduara ne vleren 75,165 mije leke shpenzime operative dhe shpenzime për investime.

Më poshtë po japim një pasqyrim të punës së bërë nga sektoret brenda drejtorisë:

- ✓ *<u>Për vitin 2025 Drejtoria jonë ka përballuar një volum të konsiderueshëm pune bazuar në gjithë veprimtarinë tonë e cila është në vijim e pandërprerë.</u>*

Në vitin 2025 vëmendja jonë si Drejtori u përqëndrua në drejtimet e mëposhtëme:

- ✓ Zbatimi i legjislacionit në fuqi për të gjithë aktivitetin ekonomiko-finaciar të Bashkisë Maliq.
- ✓ Ndjekja e situatës finaciare, të ardhurat, shpenzimet sipas programeve si edhe rezultatet kryesore të egzekutimit të buxhetit për vitin 2025.
- ✓ Ndjekja në mënyrë rigoroze e buxhetit dhe sidomos realizimit dhe likujdimit të fondeve të investimeve për vitin 2025.
- ✓ Rakordimi me Drejtorinë e të Ardhurave, Drejtorinë e Thesarit dhe të gjitha institucionet e tjera mbi arkëtimin nga taksat dhe tarifat vendore të arkëtuara gjatë vitit 2025.
- ✓ Kemi ndjekur realizimin e shpenzimeve për periudhën Janar-Dhjetor 2025 si në fushën e investimeve, shpenzimeve operative dhe pagave, sipas të gjitha strukturave buxhetore .

- ✓ Nga drejtoria jonë është ndjekur kalendari i programit buxhetor afatmesëm të bashkisë si dhe është përgatitur dokumentacioni i duhur për hartimin e project-buxhetit të bashkisë për vitet 2026-2028.
- ✓ Vëmendje e veçantë për vitin 2025 ju kushtua pagave ,rritja e të cilave ishte prioritet, janë zbatuar saktësisht VKM dhe vendimet e Këshillit Bashkiak në këtë fushë.
- ✓ Janë kryer në mënyrë të rregullt kontabilizimet në të gjithë veprimtarinë e Drejtorisë së Financës, si kontabilizimi i veprimeve të kryera me Thesarin, Arkën, Magazinën, pagat, të ardhurat, investimet dhe veprimet e ndryshme të sistemimit sipas udhëzimit përkatës për Hartimin e Pasqyrave Financiare (Bilancit vjetor).
- ✓ Në vitin 2025 u hartruan dhe miratuan pranë Thesarit korcë Pasqyrat financiare që i përkasin vitit ushtrimor 2024.
- ✓ Një punë voluminoze kjo drejtori përballoi dhe auditimin nga KLSH për veprimtarinë financiare dhe kontable , rezultatet e të cilit sapo kanë ardhur në institucion.
- ✓ Vëmendje e veçantë në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave i është kushtuar rregullshmërisë së arkëtimit të taksave dhe tarifave vendore e kryesisht në njësitë administrative.

Sektori i Menaxhimit të Aktiveve

1. Është bërë rakordimi i gjendjes fizike me atë kontabël i aseteve të të gjitha institucioneve vartëse të bashkisë për vitin 2024 dhe hartimi i dokumentacionit përkatës
2. Është bërë regjistrimi i aseteve sipas llogarive në fletët e inventarit për vitin 2025, dhe u krye inventarizimi fizik për vitin 2025
3. Është bërë skanimi dhe hedhur në sistemin AFMIS i gjithë dokumentacioni i kërkuar për çdo veprim të kryer me thesarin,urdhër shpenzime,urdhër blerje,kërkesë blerje(470)
4. Janë marrë në dorëzim të gjitha aktivet që janë bërë hyrje në bashki duke verifikuar sasinë dhe cilësinë e tyre,si dhe duke patur parasysh kushteve specifike që kërkon secili prej tyre në vlerë: 217,978,665.7 lekë si dhe është bërë furnizimi me materiale ,në bazë të kërkesave,planeve të shpërndarjes si dhe nevojave specifike që ka patur çdo Nj.Shpenzuese të Institucionit.Në vlerë :103,053,622 lekë
5. Është mbajtur dhe administruar i gjithë dokumentacioni justifikues për çdo fletë hyrje (119) /fletëdalje (1240) , kontabilizimi në program,rakordimi i çdo muaj me magazinierin si dhe të hartimi i planit të shpërndarjes së karburantit,ndjekja dhe zbatimi i normativës së harxhimit për çdo mjet.
6. Janë kryer dhe detyra të tjera si anëtare në KVO,KNJP,komisione marrje në dorëzim, dhe çdo detyrë tjetër e ngarkuar brenda drejtorisë.

Sektori i Finances ,Buxhetit ,Kontabilitetit

1. Eshte hartuar regjistri i prokurimeve,ndryshimet gjatë vitit dhe eshte ndjekur hap pas hapi.
2. Janë kryer 121(njëqind e njëzetë e një) procedura prokurimi me vlerë të vogël për blerjen e mallrave apo kryerjen e shërbimeve të ndryshme për nevoja të institucionit.
3. Është bërë kontabilizimi i 1672 arketimeve ne ditarin e arkës,134 pagesa ne ditarin e pagesave ,

4. Është bere kontabilizimi në ditarin e magazinës së 119 flete hyrjeve dhe 1240 flete daljeve në Bashki dhe NJA për vitin 2025.
5. Jane bërë 12 kontrolle për gjendjen monetare të arkës ne Bashkia Qender per cdo muaj te vitit 2025 dhe jane lene gjurmet perkatese ne librin e arkes .
6. Është bërë kontolli i dokumentacionit(libri i arkes,ditari e arketimeve dhe pagesave) dhe rakordimet e arkës së Nj A cdo muaj.
7. Është bërë rakordimi i të ardhurave në mënyrë analitike sipas artikujve midis ditarit të arkës dhe akt rakordimit me thesarin per cdo muaj.
8. Jane plotesuar 12 evidencat e realizimit te te ardhurave dhe investimeve me Prefekturen per cdo muaj.
9. Jane plotesuar 3 evidenca 4 mujore te realizimit te investimeve me Prefekturen .
10. Hartimin e urdherave per likuidimin e 5 %.
11. Është hartuar përmbledhësja e furnizimit të mjeteve me karburant cdo muaj.
12. Eshte bere deklarimi i pullave te gjendjes civile ne sisitem per deklarimin e vleres 95 % per Drejtorine e Pergjithshme te Tatimeve .
13. Hedhja në sistemi 400 AFMIS urdhërave të shpenzimit si dhe skanimi I dokumentave shoqërues të tyre.
14. Prerja e 1672 mandateve të arkëtimit ,kontrolli i dokumentave shoqërues të tyre me vlerë totale 84,489,187 lekë.
15. Regjistrimi kronologjik i 1672 mandateve të arkëtimit në ditarin e Arkës dhe në librin e Arkës.
16. Sistemimi dhe kontrolli i dokumentacioni së arkës.
17. Hartimi i 134 faturave së arkëtimit për derdhjen e shumës në bankë si dhe plotësimi i 134 mandat pagesave me vlerë totale 84,489,187 lekë
18. Hartimi i 890 faturave të arkëtimit për subjekte të ndryshme.
19. Rakordimi mujor I të ardhurave,Të ardhurat që vijnë nga kontratat,subjekte të ndryshme me Drejtorinë e Të ardhurave çdo datë 5.
20. Rakordimi i gjëndjes së pullave me Nëpunësit e Gjëndjes Civile.
21. Rakordimi i gjëndjes së biletave të tregut me Nëpunësët e financave të Njësive Administrative.
22. Rakordimi i gjëndjes së pullave me Drejtorinë Tatimore Rajonale Korçë dhe tërheqjen e pullave në DRTK
23. Llogaritja e Pagave dhe plotesimi i librave te pagave per 630 te punesuar ne muaj
24. Llogaritja dhe hedhja ne sistem i sigurimeve, gjate vitit 2025 jane hedhur ne sistem 41 te punesuar te rinj dhe jane shkeputur nga puna 35 te punesuar.
25. Llogaritja e shperblimit te 31 keshilletareve dhe 64 kryetareve te fshatrave ne muaj.
26. Llogaritja dhe hedhja ne sistem e tatimit ne burim per kontrata qeraje,shperblime keshilletare,kryepleq,shperblime dalje ne pension,shperblim eksperte.
27. Llogaritja e raporteve per Sigurimet shoqerore rreth 10 te punesuar ne muaj qe jane me raporte paaftesie ose leje lindje
28. Llogaritje e dietave per te punesuarit qe jane larguar per sherbim (81)dieta.
29. Kontrolli i bordervove te paaftesise Bashkia Qender dhe Njesive Administrative jane rreth 1243 ne muaj.
30. Llogaritja e bordervove te ndihmes ekonomike per 1689 persona ne muaj, fondit 6% per rreth 82 persona ne muaj
31. Llogaritja e bursave te 72 nxenesve te shkollave te mesme te pergjithshme

32. Pergatitja e borderove te pagesave te ndihmes financiare, ndihme per fatkeqesi,pagesat e eksperteve ,shperblime e trupa pjesemarje ne aktivitetet e Kultures ,shpronesime, ndjekja e te gjithe vendimeve te keshillit.
33. Administrimi i borderove te paaftesise ,ndihmes ekonomike ,fondi6% ,ndihma financiare me filialin e postes
34. Llogaritja e 3 vendimeve gjyqesore
35. Llogaritje e 7 Kontratave te qirave
36. Pergatitja e vertetimeve te pagave dhe baza te vleresuesshme per punonjesit .
37. -Janë ndjekur hapat për përgatitjen e Projekt Buxhetit Afatmesëm 2026-2028 nga shperndarja e kalendarit deri tek miratimi përfundimtar në këshill për 15 programet buxhetore.Janë raportuar në Ministrinë përkatëse.
38. -Janë ndjekur hapat për përgatitjen e Raportit të Monitorimit të Buxhetit dhe treguesit e performancës për të gjitha njësitë shpenzuese nga aneksi 1 deri tek ankesi 5, çdo 4-mujor dhe janë bërë raportimet në Ministri.
39. -Është bërë raportimi vjetor në Ministri mbi sistemin e Kontrollit të Brendshëm dhe plotësimi i Pyetësorit të Rishikuar të Vetëvlerësimit për komponentet e menaxhimit financiar dhe kontrollit për vitin 2024.
40. -Është hartuar Regjistri i Riskut dhe Strategjia e Menaxhimit të Riskut për vitin 2025 sipas strukturës së miratuar.
41. -Hartimi i përmbledhëses së faturave të ujit dhe energjisë çdo muaj sipas njësive administrative.
42. -Njekja e faturave elektronike dhe pranimi/refuzimi i tyre në sistem.
43. -Hedhja ne parditar e 137 furnitorëve llogaria 401-404, duke hedhur detyrimet dhe shlyerjet e tyre sipas urdhër shpenzimeve.
44. -Janë ndjekur debitorët në vazhdimësi duke rakorduar me Drejtorinë e të Ardhurave dhe DPKZHT dhe njësitë administrative duke i kontabilizuar dhe plotësuar parditarin përkatës.
45. - Plotësimi i tabelës për llogarinë 466.
46. - Marrë pjesë në Njësinë e Prokurimit për hartimin e DST.
47. - Kontrolli i evidencave të pastrimit nga KRËM dhe KORSEL çdo muaj.

Raporti i veprimtarisë për auditin e brendshëm për vitin 2025

I. Përmbledhje Ekzekutive

Njësia e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Maliq, gjatë vitit 2025 ka ushtruar veprimtarinë e saj në 8 subjekte, nga 8 subjekte të planifikuara, realizimi i planit është 100%.

Plani Strategjik dhe vjetor për vitin 2025 është miratuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresën 4368/2 prot, datë 12.10.2024 dhe nga ku rezulton se Plani i Angazhimeve të NjAB për vitin 2025 ka synuar për të audituar gjithsej 8 subjekte.

Në vitin 2025 ka pasur ndryshim të planit vjetor me shkresën nr. 2152 prot, datë 10.04.2025 miratuar nga Kryetari i Bashkisë, në të cilën si pasojë e nevojave dhe prioriteteve që ka Bashkia Maliq ishte hequr Njësia Administrative Vreshtas me kërkesë të menaxhimit të lartë dhe është shtuar Kombinati i Sheqerit Sh.a Maliq.

Është planifikuar dhe kryer auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në subjektet e audituara gjatë vitit, ç'ka lidhet dhe me performancën e veprimtarisë audituese.

Në vitin 2025 një vëmendje e veçantë nga NjAB iu kushtua dhe auditimit mbi detyrimet e prapambetura.

Nga auditimi i ushtruar në sistemet e veprimtarisë së subjekteve të audituara është vlerësuar në disa subjekte një nivel i lartë risku në sistemet e menaxhimit financiar, menaxhimin e aktiveve, në sistemin e kontrollit të brendshëm dhe menaxhimin e burimeve njerëzore.

Rekomandimet e dhëna për sistemet e audituara kanë synuar përmirësimin e dobësive dhe mangësive që gjenerojnë apo krijojnë mundësinë e shkeljeve apo mashtrimeve, me synim mospërsëritjen e tyre në të ardhmen.

Theksojmë se rekomandimet, për 8 subjektet e audituara janë gjithsej 61 të ndara në: rekomandime me prioritet të lartë 32, rekomandime me prioritet të mesëm 28 dhe rekomandime me prioritet të ulët 1.

Për t'ju dhënë rëndësinë e duhur rekomandimeve të NjAB nga ana e institucionit "Bashkia Maliq" është ndjekur dhe praktika që në përfundim të çdo auditimi, rekomandimet e lëna nga NjAB ju jepen subjekteve në formën e një urdhëri të veçantë të nxjerrë nga Kryetari i Bashkisë.

Nevojitet të përmendet se, shkalla e zbatimit të rekomandimeve është ende për të dëshiruar.

Konkretisht për vitin 2025 janë dhënë gjithsej 61 rekomandime dhe deri më datën 10.04.2026 rezulton se 36 rekomandime janë zbatuar, 19 rekomandime janë në proces zbatimi dhe 6 rekomandime janë të pa zbatuara.

Zbatimi i tyre është rreth 59%, por procesi i zbatimit të tyre vazhdon të ndiqet si nga vetë subjektet ashtu dhe nga Auditimi i Brendshëm.

Është shumë e rëndësishme të përmendet se për çdo rast gjetje është dhënë dhe rekomandimi përkatës, për shkeljet e konstatuara janë përcaktuar përgjegjësitë. Përcaktimi i përgjegjësisë ka mundësuar që rekomandimet të adresohen gjithnjë e më mirë, të jenë të zbatueshme dhe efektive për subjektet e audituara.

Struktura e miratuar e Njësisë së Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Maliq është e përbërë nga 3 vetë. Gjatë vitit 2025 struktura ka funksionuar si sektor me 1 përgjegjës dhe 2 auditues. Nga 3 punonjës gjithsej 2 janë të certifikuar dhe 1 është i pa certifikuar, për shkak të mos hapjes së kursve të certefikimit nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

II. Misioni i auditimit të brendshëm

Misioni i auditimit të brendshëm është të mbështesë menaxhimin e lartë për kryerjen e përgjegjësive të tyre. Këtë mision ai e realizon duke:

1. Mbështetur menaxhimin e organizatës publike për arritjen e objektivave.
2. Kryer vlerësime të pavarura të sistemeve, bazuar në standartet profesionale të miratuara.
3. Ngritur nivelin profesional të audituesve.

Auditimi i brendshëm ndihmon menaxhimin duke ofruar analiza, rekomandime, këshillime dhe informacione lidhur me veprimtaritë që ai ka vlerësuar sipas objektivave në subjektet e audituara.

Me strukturën e miratuar në fillim të vitit 2025 numri i subjekteve ka qënë 27 dhe me ndryshimin e bërë në strukturën e re në Shtator 2024, Njësia e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Maliq mbulon me auditim gjithsej 22 subjekte si më poshtë:

Nr.	Emërtimi i subjektit
1	Njësia Administrative Libonik

2	Njësia Administrative Pojan
3	Njësia Administrative Vreshtas
4	Njësia Administrative Pirg
5	Njësia Administrative Gorë
6	Njësia Administrative Moglicë
7	Zyra e Integrimit Europian dhe Kordinimit të Ndihmës së Huaj
8	Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
9	Drejtoria e të Ardhurave nga Taksat dhe Tarifat Vendore
10	Drejtoria Juridike dhe Prokurimet Publike
11	Drejtoria e Planifikimit,Kontrollit dhe Zhvillimit të Teritorit
12	Drejtoria e Pronave Publike dhe Aseteve
13	Inspektoriati Vendor I Mbrojtjes së Teritorit+ Mjedisit (IVMT)
14	Sektori i Emergjencave Civile
15	Drejtoria e Shërbimit Social, Arsimit dhe Shëndetësisë
16	Sektori Mbështetës dhe pajisjeve nën presion
17	Policia Bashkiake
18	Gjendja Civile
19	Mbrojtja nga Zjarri dhe Shpëtimi
20	Agjensia e Shërbimeve Mbështetëse.
21	Zyra e Bashkëqeverisjes dhe Performancës
22	Drejtoria e Burimeve Njerzore dhe Mardhënieve me Publikun
23	Kombinati I Sheqerit Sh.a Maliq
24	Klubi I Futbollit Sh.a Maliq
25	Bashkia Maliq Zbatimi I detyrave te lëna nga KLSH dhe NJAB

III. Rezultatet e Veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm

Analiza e programeve të auditimit për periudhën raportuese

Në planin e vitit 2025 janë programuar për auditim 8 subjekte dhe në fakt janë realizuar 8 auditime. Për vitin 2025 kishte ndryshim të planit të auditimit si rezultat i nevojave të institucionit. Realizimi i planit të auditimit përsa i përket numrit total është në masën 100 %.

Drejtor i financës dhe Buxhetit **Almira MUKA**

Drejtor I te Ardhurave **Jona Grabocka**

Përgjegjës Auditi i Brendshëm **Afrim Beqiraj**

MIRATOI

KRYETARI I BASHKISË

GËZIM TOPÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ